

Nr. Prot 22Nr. Prot 519

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI  
MIDIS  
ORGANIZATËS PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË –  
PREZENCA NË SHQIPËRI  
DHE  
DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS  
për**

“Sigurimin e qasjes qytetare në drejtësi nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas, sipas dispozitave të ligjit Nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (në vijim “OSBE”), përmes Prezencës së saj në Shqipëri (në vijim “Prezenca”),

dhe

“Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas” (në vijim: “Drejtoria”),

do të quhen së bashku “Palët”, dhe më vete “Pala”,

*Vlerësojnë* rëndësinë e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të shtimit të qasjes qytetare në drejtësi si parim themelor kushtetues;

*Konsiderojnë* se një nga elementët kyç të qasjes në drejtësi është ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në mënyrë profesionale, cilësore, efikase dhe efektive;

*Theksojnë* vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të këtij Memorandumi;

Për këto arsyе, Palët nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi (në vijim Memorandumi).

**Neni 1**  
**Qëllimi i MM-së**

Ky Memorandum krijon një kuadër të përgjithshëm bashkëpunimi midis Prezencës dhe Drejtorisë në lidhje me aktivitetet e planifikuara për vitin 2024 që mbështesin rritjen e qasjes qytetare në drejtësi, veçanërisht për grupet e ceneshe, duke përfshirë, por pa u kufizuar në personat me aftësi të kufizuar, viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe pakicat.

**Neni 2**  
**Fushat e bashkëpunimit**

1. Palët synojnë të bashkëpunojnë për dhënien e mbështetjes materiale dhe trajnimin e personelit të Drejtorisë dhe personelin/vullnetarët nga shoqëria civile, si dhe për të mbështetur shtrirjen dhe aktivitetet ndërgjegjësuese.
2. Palët synojnë të bashkëpunojnë për të mbështetur zhvillimin dhe trajnimin e studentëve dhe personelit që lidhet me Klinikën e themeluar për Ndihmën Juridike Falas në Universitetin e Elbasanit.

**Neni 3**  
**Roli i OSBE-së**

Sipas dispozitave të këtij Memorandumi, Prezenca në Shqipëri synon të:

1. Sigurojë dhurime materiale në formën e kopjeve fizike dhe elektronike të Udhëzuesit mbi mënyrën e komunikimit dhe pritjes së qytetarëve të kategorive vulnerabël, si dhe kopje fizike dhe elektronike të Manualit “Si të përsitojmë ndihmë juridike falas” në gjuhën angleze, dhe kopje fizike të këtij Manuali në shkrimin Braille për organizatat e shoqërisë civile që përqendrohen tek personat me aftësi të kufizuar në shikim.
2. Mundësojë dhe ofrojë trajnim për personelin e shoqërisë civile që punon në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas, sidomos atyre që punojnë me personat vulnerabël.
3. Mundësojë lidhjet midis Drejtorisë dhe klinikave të Ndihmës Juridike Falas të drejtuara nga studentët e universiteteve shtetërore.

**Neni 4**  
**Roli i Drejtorisë**

Sipas dispozitave të këtij Memorandumi, Drejtoria synon të:

1. Kryejë analiza dhe studime të përbashkëta dhe t'jua japë ato Palëve, që më pas do shqyrtojnë nevojat dhe planifikojnë ndërhyrjet sipas kompetencave ligjore.
2. Mundësojë trajnime dhe udhëzime sipas nevojës për personelin dhe studentët që punojnë me Klinikën e Ndihmës Juridike Falas të Universitetit të Elbasanit, përveç mbështetjes për referimin e individëve në klinikë, sipas rastit.
3. Bashkëpunojë dhe ofrojë mbështetjen me informacion në lidhje me vizitat në terren të Prezencës për mbledhjen e informacionit për të drejtat e njeriut.
4. Mundësojë takime për shkëmbimin e përvojave si dhe diskutimin e çështjeve me interes të përbashkët sipas rastit.

**Neni 5**  
**Përgjegjësitë**

1. Palët nuk marrin përsipër përgjegjësi për pretendimet e palëve të treta për dëme që vijnë si rrjedhojë e zbatimit të këtij Memorandumi nga Pala tjeter.

**Neni 6**  
**Komunikimi**

1. Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Memorandumit do të adresohen si më poshtë:

**Për Prezencën e OSBE-së**  
Erjola Likaj

Adresa: Prezenca e OSBE-së në Shqipëri  
Sheshi "Italia", MAK Albania Hotel  
Kati 1, 1010 Tiranë, Shqipëri  
Telefoni: +355 69 40 10 165  
E-mail: Erjola.likaj@osce.org

**Për Drejtorenë e Ndihmës Juridike Falas**  
Patricia Pogaçe

Adresa: Rr. "Jordan Misja", Godina nr.3,  
Njësia Bashkiake nr.9, Tiranë  
Telefon: +355 68 25 83 445  
E-mail: patricia.pogace@drejtesia.gov.al

2. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën sa më parë të jetë e mundur nëse do të ketë ndryshim të personave të kontaktit.

**Neni 7**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët do përpiken të zgjidhin sa më shumë në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që lindin apo që lidhen me apo interpretimin e këtij Memorandumi. Çdo mosmarrëveshje, polemikë apo pretendim që lind nga ose ka lidhje me këtë Memorandum zgjidhet me bisedime midis Palëve.

**Neni 8**  
**Privilegjet dhe imunitetet**

Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi ose që lidhet me të nuk konsiderohet si heqje dorë nga ndonjë prej privilegjeve dhe imuniteteve që gëzon OSBE-ja dhe personeli i saj.

**Neni 9**  
**Natyra jo-detyruese**

Ky Memorandum nuk është detyrues. Rrjedhimisht, asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk krijon detyrime ligjore ose financiare për asnjëren nga Palët. Në rast se mund të lindë një detyrim ligor ose finanziar nga ndonjë prej aktiviteteve, marrëveshje e veçantë do të lidhet përpara se të ndërmerrat një aktivitet i tillë.

**Neni 10**  
**Ndryshimet**


Çdo lloj ndryshimi i këtij Memorandumi mund të bëhet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të dy Palëve. Për më tepër, këshillimet me qëllim ndryshimin e këtij Memorandumi mund të bëhen me kërkesë të njërit prej Palëve.

**Neni 11**  
**Dispozita përfundimtare**

1. Aktivitetet sipas këtij Memorandum mund të fillojnë me nënshkrimin e tij nga të dyja Palët. Ai mbetet i vlefshëm për një (1) vit, dhe mund të zgjatet me miratimin e të dyja Palëve. Memorandumi i Mirëkuptimit mund të ndërpritet nga secila Palë duke i dërguar Palës tjetër 30 ditë përparrë njoftimin me shkrim.

2. Ky Memorandum hartohet në katër (4) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Secila Palë merr dy (2) kopje, një për secilën gjuhë. Në rast mosmarrëveshjeje për interpretimin e dispozitave të këtij Memorandumi, përparësi do të ketë varianti në gjuhën angleze.

**Për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri**



Kryetarja në Detyrë e Prezencës  
Clarisse Pasztori

**Për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas**



Drejtori i Përgjithshëm  
Ergys Qirici

Data: 22/12/24

Data: 22/12/2024